



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

VENDIM
Nr. 228, datë 23.04.2026

PËR
TRANSFERIMIN E GJYQTARIT ZNJ. GENTIANA XHELILI NË PROCEDURËN
E LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS
SË PARË TIRANË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 85 e 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 7,10 dhe 12, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 242, datë 02.05.2024, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtarit znj. Gentiana Xhelili në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 24.04.2026.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. Gentiana Xhelili sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR